



## Prokurimi publik

# Nënkontraktimi

### PËRMBAJTJA

- [Hyrie](#)
- [Arsyet e nënkontraktimit](#)
- [Cfarë thotë Direktiva për nënkontraktimin](#)
  - [Mbështetja tek nënkontraktorët për plotësimin e kërkesave të fazës së përzgjedhjes](#)
  - [Informacion mbi organizimet e nënkontraktimit dhe nënkontraktorët](#)
  - [Verifikimi i nënkontraktorëve](#)
  - [Realizimi i kontratës](#)
  - [Përputhshmëria e nënkontraktorëve dhe e nënkontraktimit me detyrimet lidhur me të drejtën e punës, sociale dhe mjedisore](#)
  - [Dispozita jo të detyrueshme lidhur me nënkontraktimin](#)
- [Çështje praktike lidhur me nënkontraktimin – pyetje dhe përgjigje](#)
- [Shërbimet](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

## Hyrje


Nënkontraktimi ndodh kur një operator ekonomik që i është dhënë një kontratë publike (kontraktori) ia beson një tjetër subjekti kryerjen e një pjese të punëve ose shërbimeve që janë objekt i kësaj kontrate. Subjekti i dytë, i ngarkuar me kryerjen e një pjese të punëve ose shërbimeve, quhet "nënkontraktor".

Kontraktori mund të përdorë një ose më shumë nënkontraktorë. Nënkontraktorët mund të nënkontraktojë gjithashtu disa elemente të punëve ose shërbimeve që atyre u kërkohet që të realizojnë në përputhje me organizimet nënkontraktore me kontraktorin (nënkontraktimi i mëtejshëm).

Edhe pse nënkontraktori përfshihet në realizimin e një pjese të kontratës, kontraktori është përgjegjës dhe jep llogari para autoritetit kontraktor për realizimin e duhur të kontratës.

Në shumë raste, nënkontraktimi mund të jenë i nevojshëm ose i dobishëm. Për shembull, për punimet e ndërtimit, kontraktori kryesor mund të vendosë t'ia besojë kompanive të tjera një numër aktivitete të specializuara, të tilla si instalimet hidraulike, punimet mekanike dhe inxhinierike, dhe lyerja.

### Kontratat e punëve të ndërtimit për një ndërtesë të re – marrëveshjet e nënkontraktimit



Një situatë e ngjashme vlen edhe për shërbimet e trajnimit, ku ofruesi i shërbimit mund të kenë nevojë që të nënkontraktojë operatorë të tjerë ekonomik të shërbimeve të kateringut, akomodimit dhe të transportit për pjesëmarrësit.

Direktiva e Sektorit Publik (Direktiva)<sup>1</sup> nuk e përkufizon termin "nënkontraktor". Megjithatë, ky term është përcaktuar në dispozitat kombëtare të disa Shteteve Anëtare. Për shembull, në Poloni, nënkontrata është përcaktuar si një kontratë me shkrim me shpërblim në para që ka për objekt shërbime, furnizime apo punë që përbëjnë një pjesë të kontratës publike që lidhet ndërmjet një operatori ekonomik të zgjedhur nga ana e autoritetit kontraktor dhe një njësie tjetër ekonomike (nënkontraktori). Nënkontrata e shërbimeve, furnizimeve ose e punëve mund të lidhet ndërmjet nënkontraktorit dhe një nënkontraktor ose nënkontraktorë të mëtejshëm. Në mënyrë të ngjashme, dispozitat italiane e përcaktojnë nënkontraktimin si një kontratë sipas së cilës kontraktori i beson palëve të treta realizimin e një pjese të shërbimeve ose punëve që janë objekt i kontratës publike.

Përkufizimet kombëtare, kur përdoren, kanë karakteristika të përbashkëta, në atë që ato ose specifikojnë ose thonë se nënkontraktimi mund të përbëjë vetëm një pjesë ose disa pjesë të një kontrate. Ndonjëherë, legjislacioni kombëtar përcakton një pjesë maksimale e kontratës që mund të nënkontraktohet tek palët e treta, e shprehur si një përqindje e vlerës totale të kontratës së prokurimit.

### Arsyet e nënkontraktimit

Operatorët ekonomikë kanë arsye të ndryshme dhe të justifikuara për të përdorur nënkontraktimin. Kjo gjë ka shpesh kuptim në planin financiar dhe në atë të biznesit. Për shembull, një operator ekonomik (kontraktori) mund të gjejë se është më lirë që të përdoret një nënkontraktor i specializuar për një element specifik të kontratës në vend që ta realizojë vetë atë element të kontratës. Arsyeja për këtë është se nënkontraktori i specializuar ka pajisjet dhe ekspertizën e nevojshme, të cilat kontraktori nuk i ka. Në disa raste, kontraktori mund të mos jetë i autorizuar për të ofruar të gjitha shërbimet ose punët e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

#### Shembull

Një kontraktor që realizon një kontratë punësh mund t'ia besojë punimet një kompanie tjetër që ka autorizimet ose licencat e nevojshme specifike për depozitimin e mbetjeve të rrezikshme nga një vend ndërtimi.

Si një qasje alternative ndaj nënkontraktimit, kontraktori dhe kompania e specializuar e depozitimit të mbetjeve mund të krijojnë një grup dhe së bashku të nënshkruajë një kontratë me autoritetin kontraktor. Megjithatë, nga këndvështrimi i kompanisë së depozitimit të mbetjeve, kjo qasje mund të jetë e papranueshme, pasi kontrata mund të kërkojë të marrë përsipër detyrimet që nuk janë të lidhura me detyrat që do të kryejnë. Organizimi i një nënkontrate me përgjegjësi të kufizuar ka të ngjarë të jetë një zgjidhje shumë më tërheqëse për kompaninë e depozitimit të mbetjeve.

Nënkontraktimi gjithashtu mund të jetë i dobishëm për një operator ekonomik që nuk i plotëson të gjitha kriteret e kualifikimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatori ekonomik është në gjendje të mbështetet tek nënkontraktorët për të plotësuar kapacitetet apo burimet që i mungojnë në mënyrë që të kualifikohet për të marrë pjesë në procesin e prokurimit për dhënien e një kontrate publike. Për më shumë detaje shih diskutimet më poshtë dhe Udhëzimin nr. 7 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Përzgjedhja e operatorëve ekonomik*.

Nënkontraktimi mund të lehtësojë aksesin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në prokurimin publik. Një NVM mund të mos jetë në gjendje të realizojë një kontratë të tërë për shkak të madhësisë së saj, specializimit, apo burimeve të kufizuara, por mund të jetë krejtësisht në gjendje që të realizojë disa nga shërbimet ose punët e përfshira në një projekt të

<sup>1</sup> Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

madh. Për më shumë informacion, shih Udhëzimin nr. 33 të SIGMA-s për Prokurimin publik, NVM-të në Prokurimin publik.

Mund të ketë raste kur nënkontraktimi përdoret për arsye të gabuara, për shembull, si një mënyrë për të lehtësuar marrëveshjet e fshehta ose manipulimin e ofertave. Kërkesa në avancë për më shumë detaje në lidhje me nënkontraktorët e mundshëm mund të ndihmojë në uljen e rrezikut të marrëveshjeve të fshehta apo të manipulimit të ofertave. Për më shumë informacion, shih Udhëzimet e OECD-së për *Luftën kundër manipulimit të ofertave në prokurimin publik*.<sup>2</sup>

## Çfarë thotë Direktiva për nënkontraktimin

### Mbështetja tek nënkontraktorët për plotësimin e kërkesave të fazës së përzgjedhjes

Neni 63 i Direktivës e lejon operatorin ekonomik që të mbështetet tek gjendja ekonomike dhe financiare, si dhe tek aftësinë teknike dhe profesionale të një pale të tretë, në mënyrë që të plotësojë kërkesat e fazës së përzgjedhjes. Ky besim në kapacitetet e subjekteve të tjera lejohet pa marrë parasysh natyrën ligjore të marrëveshjeve në mes të operatorit ekonomik që dëshiron që të marrin pjesë në procesin e prokurimit dhe palëve të treta tek të cilat ai mbështetet.<sup>3</sup> Nënkontraktimi është një nga mënyrat me të cilën operatori ekonomik dhe palët e tij të treta mund të lidhen.

Aneksi XII i Direktivës përcakton mjetet e provës që mund të ofrohen nga operatorët ekonomikë për të treguar se ata i përmbushin kriteret e përzgjedhjes. Një ndër mjetet e provës për aftësinë teknike është "tregues i përqindjes së kontratës që operatori ekonomik planifikon që mundësisht ta nënkontrakttojë". Prandaj, Direktiva është shumë e qartë kur shprehet se një operator ekonomik mund të provojë se i plotëson këto kërkesa duke siguruar informacion në lidhje me nënkontraktorët e tij të ardhshëm.

Gjatë procesit të përzgjedhjes, operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se, në fazën e realizimit të kontratës, ai do të jetë në gjendje të përdorë kapacitetet e palëve të treta tek të cilat ai mbështetet për të përmbushur kriteret e fazës së përzgjedhjes. Ai duhet të provojë se lidhjet e tij me palët e treta janë thjesht një mjet i vërtetë dhe jo artificial në funksion të plotësimin të kërkesave të përzgjedhjes. Ekziston një kërkesë e përgjithshme që e detyron operatorin ekonomik që të provojë para autoritetit kontraktor se ai do të ketë burimet e nevojshme në dispozicion. Ai mund ta bëjë këtë, për shembull, "duke ndërmarrë një angazhim të këtyre subjekteve për këtë qëllim".

Kur një operator ekonomik propozon që të mbështetet në kapacitetet e palëve të treta për të përmbushur kërkesat lidhur me formimin arsimor ose me përvojën përkatëse profesionale, ai mund të veprojë kështu vetëm kur këto palë të treta do të kryejnë në të vërtetë punët ose shërbimet për të cilat kërkohen këto kapacitete.

### Kufizimet ndaj mbështetjes tek burimet e palëve të treta, duke përfshirë nënkontraktimin:

Neni 63 (2) i Direktivës përfshin një kufizim të veçantë për nënkontraktimin. Në rastin e "kontratave të punëve, kontratave të shërbimit dhe të operacioneve të vendosjes apo të instalimit në kuadrin e një kontratë furnizimi, autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që disa detyra kritike të kryhen direkt nga vetë ofertuesi ose, kur oferta dorëzohet nga një grup operatorësh ekonomik.....nga një pjesëmarrës i atij grupi".

<sup>2</sup> OECD (2009), *Udhëzimet për luftën kundër manipulimit të ofertave në prokurimin publik*, Botimet e OECD-së, Paris.

<sup>3</sup> Shih, për shembull, çështjen e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJED), C-389/92 Ballast Nedam Groep në lidhje me varësinë nga burimet e palëve të treta brenda një strukture grupi të kompanive dhe çështjen e GJED-së C-176/98 Holst Italia në lidhje me mbështetjen në burimet e palës së tretë në kuadrin të organizimeve të sipërmarrjes së përbashkët.

Në këtë rast, kontraktori duhet t'i kryejë ato detyra direkt. Nuk lejohet as t'i nënkontrakttojë dhe t'ia besojë këto detyra palëve të treta.

### **Informacion mbi organizimet e propozuara të nënkontraktimit dhe nënkontraktorët**

Aftësia e një operatori ekonomik për t'u mbështetur tek palët e treta për të plotësuar kriteret e fazës së përzgjedhjes duhet të merret parasysh nga autoriteti kontraktor në fazën e planifikimit të procesit të prokurimit.

Sipas nenit 71 (2) të Direktivës, autoriteti kontraktor lejohet t'i kërkojë një operatori ekonomik që ai të tregojë në ofertën e tij "çdo pjesë të kontratës që mund të nënkontrakttojë tek palët e treta dhe çdo nënkontraktor të propozuar". Dispozitat kombëtare mund t'i detyrojnë autoritetet kontraktore që ta kërkojnë këtë informacion nga operatorët ekonomikë.

Është e dobishme që autoriteti kontraktor ta ketë paraprakisht këtë informacion mbi organizimet nënkontraktore në mënyrë që ai ta dijë se cili subjekt ose subjekte do të realizojnë kontratën. Kërkesa për këtë informacion duhet të përfshihet në dokumentet e prokurimit dhe për këtë arsye kjo çështje duhet të merret parasysh në fazën e planifikimit.

Përveç kësaj, siç tashmë u përmend më lart, autoriteti kontraktor mund të kërkojë dëshmi nga një operator ekonomik që është duke synuar të mbështetet tek burimet e një pale të tretë, përfshirë një nënkontraktor, në mënyrë që të sigurohet se do të ketë burimet e nevojshme në dispozicionin e tij. Përfshirja e një kërkesë për informacionin përkatës dhe provat në dokumentet e prokurimit përbën një element të ndjeshëm.

### **Verifikimi i nënkontraktorëve**

**Verifikimi i shkaqeve të përjashtimit:** operatorët ekonomikë mund të përjashtohet nga procesi i prokurimit, kur shkaqet e detyrueshme, ose jo të detyrueshme të përjashtimit.

Neni 63 (1) të Direktivës parashikon që kur një operator ekonomik propozon që të përdorë një nënkontraktor për realizimin e një pjese të objektit të kontratës, autoritetet kontraktore duhet të verifikojë nëse ka apo jo arsye për përjashtimin e nënkontraktorit.

Kur procesi i verifikimit tregon se ekzistojnë arsyet e detyrueshme për përjashtimin që aplikohen ndaj një nënkontraktori, atëherë autoriteti kontraktor duhet ta detyrojë operatorin ekonomik që të zëvendësojë nënkontraktorin ndaj të cilit aplikohen këto baza.

Në rastin e arsyeve jo të detyrueshme të përjashtimit, autoritetet kontraktore mund të kërkojnë, ose mund të detyrohen nga Shtetet Anëtare që të kërkojnë, që operatori ekonomik të zëvendësojë një nënkontraktor ndaj të cilit zbatohen këto shkaqe.

Kur kërkohet për qëllime të verifikimit të ekzistencës së arsyeve të përjashtimit të një nënkontraktori, informacioni i kërkuar duhet të shoqërohet me vet-deklarimin e nënkontraktorit në Dokumentin Unik Evropian të Prokurimit (DUEP). Masat zbatuese të miratuara nga Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që një nënkontraktor që është paraqitur pas dhënies së kontratës duhet të dorëzojë certifikatat dhe dokumentet e tjera mbështetëse në vend të vet-deklarimit (DUEP). Për më shumë informacion mbi DUEP-in, shih Udhëzimin nr. 7 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Përzgjedhja e operatorëve ekonomik*.

**Verifikimi i kriterëve të dhënies së kontratës:** Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.

Neni 63 (1) të Direktivës parashikon që kur një operator ekonomik propozon që të përdorë një nënkontraktor për realizimin e një pjese të objektit të kontratës, autoritetet kontraktore duhet të verifikojë nëse nënkontraktori i propozuar i përmbush apo jo kriteret përkatëse të përzgjedhjes.

Kur një proces i verifikimit tregon që nënkontraktori nuk i plotëson kriteret përkatëse të përzgjedhjes, atëherë autoriteti kontraktor duhet ta detyrojë operatorin ekonomik që ta zëvendësojë nënkontraktorin.

Kur një operator ekonomik mbështetet në kapacitetet e një nënkontraktori, ose të nënkontraktorëve për plotësimin e kriterëve lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare, atëherë autoriteti kontraktor mund ta detyrojë operatorin ekonomik dhe nënkontraktorin apo nënkontraktorët që të jenë së bashku përgjegjës për realizimin e kontratës.

### Realizimi i kontratës

Sipas Direktivës, operatorit ekonomik që synon të përdorë një nënkontraktor ose disa nënkontraktorë për të ofruar një pjesë të punëve ose shërbimeve nuk i kërkohet që të informojë në mënyrë automatike autoritetin kontraktor për qëllimin e tij për ta bërë këtë.

Siç u përmend më lart, autoriteti kontraktor ka të drejtë ta kërkojë këtë informacion nga operatori ekonomik në fazën e tenderit, si dhe në disa Shtete Anëtare mund të jetë i detyruar për ta bërë këtë. Megjithatë është e mundshme që një operator ekonomik që nuk ka kërkuar që të mbështetet në burimet ose kapacitetet e një nënkontraktori për të përmbushur kriteret e përzgjedhjes të njoftojë autoritetin kontraktor mbi organizimet nënkontraktore pasi është dhënë kontrata.

E drejta kombëtare mund të kërkojë që një operator ekonomik të marrë miratim paraprak nga autoriteti kontraktor për çfarëdo nënkontraktimi që nuk ka qenë i përfshirë në tender.

**Kërkesat specifike për informacionin mbi nënkontraktorët:** Dispozitat specifike të nenit 71 (5) të Direktivës kanë të bëjnë me kontratat e punëve dhe me disa kontrata të shërbimeve që kërkojnë që autoritetit kontraktor t'i jepet informacion mbi nënkontraktorët.

Në rastin e kontratave të shërbimeve dhe të punëve që do të ofrohen në një objekt që është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të autoritetit kontraktor, kontraktori kryesor duhet që t'i "tregojë [në ofertë] autoritetit kontraktor emrin, detajet e kontaktit dhe përfaqësuesit ligjorë të nënkontraktorëve të tij të përfshirë në punë ose shërbime të tilla, aq sa janë të njohura".

Autoriteti kontraktor duhet ta kërkojë këtë informacion "pas dhënies së kontratës dhe jo më vonë kur të ketë filluar realizimi i kontratës".

Autoriteti kontraktor duhet ta detyrojë kontraktorin kryesor që ta njoftojë atë për çdo ndryshim të këtij informacioni gjatë realizimit të kontratës dhe t'i japë atij informacionin e kërkuar për çdo nënkontraktor të ri që mund të përfshijë më vonë në punët ose shërbimet.

Kjo dispozitë nuk zbatohet në lidhje me furnizuesit. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund ta shtrijnë këtë detyrim ndaj kontratave të furnizimeve apo shërbimeve në objekte që nuk janë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të autoritetit kontraktor dhe tek furnizuesit që janë të përfshirë në kontratat për punët ose shërbimet.

Shtetet anëtare mund të imponojnë drejtpërdrejt detyrimin për të dhënë informacionin e kërkuar mbi kontraktorin kryesor.

### Përputhshmëria e nënkontraktorëve dhe e nënkontraktimit me detyrimet lidhur me të drejtën e punës, sociale dhe mjedisore

Direktiva përmban një dispozitë e detyrueshme e cila i kërkon autoriteteve kompetente kombëtare që të sigurojnë që nënkontraktorët të veprojnë në përputhje me detyrimet përkatëse që rrjedhin nga e drejta e detyrueshme e BE-së ose nga e drejta kombëtare në përputhje me të drejtën e BE-së në fushat e së drejtës sociale, të punës ose të drejtës mjedisore ose në përputhje me dispozitat e të drejtës ndërkombëtare të punës. Prandaj, nënkontraktorët kanë të njëjtat detyrime si kontraktorët kryesorë në lidhje me respektimin e këtyre rregullave ligjore.

Për të shmangur çdo shkelje të këtyre detyrimeve, Direktiva jep shembuj të "masave të përshtatshme", që mund të merren nga Shtetet Anëtare ose drejtpërdrejt nga autoritetet kontraktore: përgjegjësia e përbashkët dhe verifikimi.

**Përgjegjësia e përbashkët:** E drejta kombëtare e një Shteti Anëtar mund të parashikojë përgjegjësinë e përbashkët të kontraktorit kryesor dhe të nënkontraktorëve. Shteti Anëtar duhet të sigurojë që rregullat përkatëse zbatohen në përputhje me detyrimet e Direktivave që lidhen me të drejtën e punës, sociale dhe mjedisore.

**Verifikimi:** Siç është shpjeguar në hollësi më sipër, autoritetet kontraktore mund të verifikojnë, ose mund të jenë të detyruara të verifikojë sipas dispozitave kombëtare nëse ka arsye apo jo për përjashtimin e nënkontraktorëve, duke përfshirë edhe përjashtimin bazuar në shkaqet e mospërputhshmërisë me detyrimet që kanë të bëjnë me të drejtën e punës, sociale dhe mjedisore.

### Dispozita jo të detyrueshme lidhur me nënkontraktimin

Direktiva siguron një numër zgjidhjesh jo të detyrueshme për Shtetet Anëtare, disa prej të cilave tashmë janë diskutuar në këtë udhëzim. Dy dispozita të veçanta - pagesa e drejtpërdrejtë për nënkontraktorët dhe informacioni mbi nënkontraktorët - diskutohen më poshtë.

Shtetet Anëtare që vendosin për të rregulluar dispozitat jo të detyrueshme në lidhje me nënkontraktimin në të drejtat e tyre kombëtare mund të kufizojë aplikimin e tyre, për shembull në lidhje me disa lloje kontratash, kategorish të caktuara të autoriteteve apo operatorëve ekonomikë, apo kontratash për shuma të caktuara.

**Pagesat e drejtpërdrejta:** Shtetet Anëtare mund të parashikojnë se "... me kërkesë të nënkontraktorit dhe kur natyra e kontratës e lejon, autoriteti kontraktor transferon direkt tek nënkontraktori pagesat që duhen bërë për shërbimet, furnizimet ose punët që i janë dhënë operatorit ekonomik të cilit i është dhënë kontrata publike (kontraktori kryesor). Masat e tilla mund të përfshijnë mekanizmat e duhur që lejojnë që kontraktori kryesor të kundërshtojë pagesat e panevojshme. Aranzhimet lidhur me atë mënyrën e pagesës duhet të përcaktohen në dokumentet e prokurimit."

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë rregulla me përgjegjësi më të rreptë sipas ligjit kombëtar, apo për pagesat direkte për nënkontraktorët pa u kërkuar atyre që të bëjnë kërkesë për pagesa të tilla të drejtpërdrejta.

**Zgjerimi i detyrimit për të dhënë informacion në lidhje me nënkontraktorët:** Shtetet Anëtare lejohen që të shtrijnë detyrimet lidhur me dhënien e informacionit të kërkuar nga kontraktorët për nënkontraktorët e tyre në fazën e realizimit të kontratës për të përfshirë, për shembull, nënkontraktorët e nënkontraktorëve të kontraktorit kryesor ose më poshtë në zinxhirin e nënkontraktimit.

Siç është shpjeguar tashmë në hollësi më sipër, Shtetet Anëtare mund t'i shtrijnë kërkesat e informacionit tek kontratat e furnizimeve, kontratat e shërbimeve të ndryshme nga ato në lidhje me shërbimet që do të ofrohen në objektet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të autoritetit kontraktor, ose tek furnizuesit e përfshirë në kontratat e punëve ose shërbimeve.

## Shembull i zgjidhjeve kombëtare

**Franca:** Në Francë,<sup>4</sup> kontraktori mund të nënkontrakttojë pjesë të veçanta të kontratës tek palët e treta me kusht që të marrë miratimin e autoritetit kontraktor në lidhje me secilin nënkontraktor, si dhe kushtet e pagesës së tij, në avancë.

Kërkesa në lidhje me nënkontraktimin mund të bëhet ose (1) në fazën e tenderimit, kur ofertuesi jep në ofertën e tij informacionin mbi shërbimet e mbuluara nga nënkontraktimi, emrat e nënkontraktorëve, si dhe kushtet financiare të përcaktuara në projekt nënkontratë; ose (2) gjatë realizimit të kontratës. Në rastin e parë, njoftimi i dhënies së kontratës do të thotë edhe miratimin e nënkontraktimit të përmendur në ofertën fituese, duke përfshirë kushtet përkatëse të pagesës. Në rastin e dytë, kontraktori është i detyruar t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kërkesë të veçantë, me shkrim, që përmban të njëjtin lloj të informacionit siç tregohet më lart.

Nënkontraktimi lejohet nëse të dyja palët në kontratën kryesore nënshkruajnë një marrëveshje të veçantë. Autoriteti kontraktor konsiderohet se miraton nënkontraktimin nëse nuk i përgjigjet kërkesës së kontraktorit brenda 21 ditëve nga marrja e kërkesës.

Të gjithë nënkontraktorët që janë miratuar nga autoriteti kontraktor kanë të drejtë që të marrin drejtpërdrejt pagesën nga ana e autoritetit kontraktor për pjesët e kontratës që ata realizojnë, me kusht që vlera e nënkontraktimit të arrijë ose të tejkalojë 600 Euro.

**Polonia:** Në Poloni,<sup>5</sup> Ligji i Prokurimit Publik përmban një numër dispozitash që kanë për qëllim garantimin që kontraktori paguan siç duhet të gjithë nënkontraktorët. Këto dispozita synojnë në mënyrë specifike nënkontraktimin në rastin e kontratave të punëve.

Operatorët ekonomikë dhe nënkontraktorët që synojnë të përfundojnë një nënkontratë që ka si objekt punët janë të detyruar, gjatë realizimit të kësaj kontrate, që t'i paraqesin autoritetit kontraktor një projekt nënkontratë. Nënkontraktorët, në anën tjetër, që synojnë të nënkontraktojnë më tej janë të detyruar të marrin pëlqimin e operatorit ekonomik për lidhjen e një nënkontrate.

Afati për pagesën e shpërblimit të nënkontraktorit apo të nënkontraktorit mëtejshëm të parashikuar në nënkontratë nuk mund të kalojë 30 ditë nga dorëzimi i faturës apo e mandatit që konfirmon realizimin e furnizimeve, shërbimeve ose punëve të caktuara nënkontraktorit apo nënkontraktorit të mëtejshëm.

Pagesa e drejtpërdrejtë e shpërblimit të duhur nga autoriteti kontraktor bëhet, nëse operatori ekonomik ose nënkontraktori shmang pagesën e shpërblimit për nënkontraktorët e tij ose nënkontraktorët e mëtejshëm. Megjithatë, kjo pagesë zbatohet vetëm në lidhje me pretendimet për pagesën që dalin pas pranimit të nënkontratës nga autoriteti kontraktor. Autoriteti kontraktor zbrit nga pagesa që i detyrohet operatorit ekonomik shumë që ka pasur për të paguar direkt tek nënkontraktori.

Nevoja për pagesa të shumëfishta të drejtpërdrejta për nënkontraktorët apo nënkontraktorët e mëtejshëm ose nevoja për pagesën e drejtpërdrejtë për një shumë që përfaqëson më shumë se 5% të vlerës së të gjithë kontratës mund të çojë në tërheqjen e autoritetit kontraktor nga kontrata.

<sup>4</sup> Décret n° 2016-360 du 25 mars 2016 relatif aux marchés publics, JORF n°0074 du 27 mars 2016, Articles 133-137. Versioni i konsoliduar i datës 14 korrik 2016 është i disponueshëm në:

<https://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=JORFTEXT000032295952&dateTexte=20160714>

<sup>5</sup> Akti i datës 29 janar 2004 Ligji i Prokurimit Publik, i ndryshuar, neni 143a-143b, është i disponueshëm në:

[https://www.uzp.gov.pl/\\_data/assets/pdf\\_file/0015/30336/Public\\_Procurement\\_Law\\_2015\\_consolidated.pdf](https://www.uzp.gov.pl/_data/assets/pdf_file/0015/30336/Public_Procurement_Law_2015_consolidated.pdf)



## Çështje praktike lidhur me nënkontraktimin – pyetje dhe përgjigje

**A i lejohet një autoriteti kontraktor që ta detyrojë një kontraktor që ai të nënkontrakttojë pjesë të kontratës ose të përdorë një nënkontraktor të veçantë?** Direktiva nuk i lejon autoritetet kontraktore që të kërkojnë nënkontraktim. Përdorimi i nënkontraktimit është në diskrecionin e operatorit ekonomik.<sup>6</sup>

Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që kontraktori të angazhojë një nënkontraktor të veçantë. Një kërkesë e tillë do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

**A i lejohet një operatori ekonomik që të nënkontrakttojë 100% të kontratës (të gjithë kontratën)?** Direktiva nuk ndalon në mënyrë eksplicite nënkontraktimin e një kontrate të tërë, por mund të argumentohet se ky ndalim nënkuptohet nga dispozitat e Direktivës në lidhje me nënkontraktimin, të cilat kanë të bëjnë me "pjesën" e kontratës që kontraktori ka për qëllim të nënkontrakttojë. Në disa Shtete Anëtare, dispozitat kombëtare ndalojnë në mënyrë eksplicite nënkontraktimin e të gjithë kontratës duke e trajtuar atë si të barabartë me cedimin e kontratës, gjë e cila në përgjithësi nuk lejohet në prokurimin publik.

**A është e mundur që një autoritet kontraktor të kufizojë përdorimin e nënkontraktimit?** Në disa raste është i mundur kufizimi i nënkontraktimit. Nënkontraktimi mund të përjashtohet në të gjitha rastet kur karakteristikat specifike të individit që kryen shërbimet kanë qenë një faktor vendimtar për lidhjen e kontratës me atë person. Kjo situatë mund të ketë të bëjë me aktivitete kulturore ose artistike, shërbime intelektuale, si dhe me fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor, si dhe me situata të ngjashme, ku cilësitë dhe karakteristikat e ofruesit të shërbimit kanë qenë vendimtar në zgjedhjen e tij/saj. Shembujt mund të përfshijnë një këngëtar të famshëm ose një fitues të çmimit Nobel.

Direktiva i lejon autoritetet kontraktore që të kërkojnë kryerjen e disa "detyrave kritike" direkt nga ofertuesi ose, nëse kontrata i është dhënë një grupi operatorësh ekonomik, nga një prej anëtarëve të grupit. Nëse është i nevojshëm realizimi i drejtpërdrejtë, atëherë nënkontraktimi i këtyre detyrave të rëndësishme përjashtohet në mënyrë implicite. Kërkesa në lidhje me realizimin e drejtpërdrejtë të një kontrate lejohet për kontratat e punëve, kontratat e shërbimeve, dhe operacionet e vendosjes apo të instalimit në kuadër të kontratave të furnizimeve. GJED-ja është shprehur se një operator ekonomik mund të mos lejohet që të nënkontrakttojë pjesët thelbësore të kontratës, kur operatori ekonomik nuk arrin të tregojë në fazën e vlerësimit të ofertave që kapacitetet teknike dhe ekonomike të palës së tretë do të jenë të disponueshme.<sup>7</sup>

Sipas mendimit të GJED-së, kufizimi i përdorimit të nënkontraktorëve për një pjesë të kontratës që është fiksuar në terma abstrakte, të tilla si përqindja e caktuar e kësaj kontrate, nuk është në përputhje me Direktivën e Sektorit Publik 2004.<sup>8</sup> GJED-ja e ka shprehur këtë mendim në një çështje në lidhje me një kërkesë, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e prokurimit, ku të paktën 25% e punëve që ishin objekt i prokurimit duhet të kryheshin nga kontraktori duke përdorur burimet e veta.<sup>9</sup>

<sup>6</sup> Dispozitat nënkontraktore të detyrueshme janë të përfshira vetëm në Direktivën e Prokurimit të Mbrojtjes dhe të Sigurisë - Direktiva 2009/81/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të caktuara të punëve, kontratave të furnizimit dhe kontratave të shërbimeve nga autoritetet apo subjektet kontraktore në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për ndryshimin e Direktivës 2004/17/KE dhe 2004/18/KE, 13 korrik 2009.

<sup>7</sup> Çështja e GJED-së C-314/01 *Siemens dhe ARGE*.

<sup>8</sup> Direktiva 2004/18/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, 31 mars 2004.

<sup>9</sup> Çështja e GJED-së C-406/14 *Wrocław – Miasto na prawach powiatu*.

**A është e mundur të ndryshohet një nënkontraktor?** Është e mundur në disa raste që gjatë realizimit të kontratës të ndryshohet një nënkontraktor, edhe nëse identiteti i nënkontraktorit origjinal është përfshirë në ofertën fituese.

Megjithatë, praktika gjyqësore e GJED-së ka konfirmuar se ndryshimi i një nënkontraktori do të jetë një ndryshim material i kontratës, gjë e cila passjell nevojën për një procedurë të re për dhënien e kontratës në qoftë se nënkontraktori i veçantë ka qenë një "faktor vendimtar" në vendimin e autoritetit publik për dhënien e kontratë kryesore ofertuesit të suksesshëm.<sup>10</sup> Arsyetimi i GJED-së ka qenë si vijon: nëse Kompania A ka theksuar aftësitë dhe cilësitë e një nënkontraktori të caktuar të ardhshëm (Nënkontraktori B) në ofertën e saj dhe nëse këta faktorë kanë luajtur një rol vendimtar në vendimin për dhënien e kontratës kompanisë A, atëherë do të ishte e padrejtë ndaj ofertuesve të tjerë që të lejohej që ofertuesi të zëvendësonte një nënkontraktor me Nënkontraktorin B. Megjithatë, një zëvendësim i tillë lejohet në qoftë se nënkontraktori i ri ka kualifikime dhe cilësi të barabarta.

Mundësia e ndryshimit të nënkontraktorëve nënkuptohet edhe nga dispozitat e nenit 71 të Direktivës, të cilat i detyrojnë autoritetet kontraktore që t'u kërkojnë kontraktorëve që të njoftojnë për çdo ndryshim në lidhje me nënkontraktorët, duke përfshirë informacionin mbi të gjithë nënkontraktorët e rinj që janë përfshirë më pas në kryerjen e punëve ose të shërbimeve në fjalë.

## Shërbimet

Neni 88 i Direktivës së Shërbimeve<sup>11</sup> përmban dispozita praktikisht identike me dispozitat nënkontraktore të Direktivës së Sektorit Publik.

Neni 79 i Direktivës së Shërbimeve përmban praktikisht dispozita të njëjta në lidhje me varësinë nga burimet e palëve të treta, si ato që janë në Direktivën e Sektorit Publik.

Direktiva e Shërbimeve nuk përmban dispozita të hollësishme në lidhje me kriteret e përzgjedhjes që mund të përdoren nga subjektet kontraktore. Ajo nuk ofron një listë të referencave që mund të përdoren si mjet për të provuar kapacitetet teknike. Arsyeja për këto mosveprime është se dispozitat e Direktivës së Shërbimeve në përgjithësi janë më fleksibël në lidhje me këto kritere se sa dispozitat e Direktivës së Sektorit Publik.

<sup>10</sup> Çështja e GJED-së C-91/08 *Wall*.

<sup>11</sup> Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

## Informacion i mëtejshëm

### Botime

SIGMA (2015), *Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik* – Moduli E3, Botimet e OECD-së,

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik (2006-2014)*, Botimet e OECD-së, Paris.

<http://www.sigmaweb.org/publications/Judgements-CourtJustice-31July2014-Alb.pdf>

### Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Përzgjedhja e operatorëve ekonomik*, Udhëzimi 7, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *NVM-të në prokurimin publik*, Udhëzimi 33, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Modifikimet e kontratave*, Udhëzimi 38, Botimet e OECD-së, Paris.